



---

## Biografi e shkurtër

---

### **Olsa Nikolla, Këshilltare Ligjore**

Znj.Olsa Nikolla në vitin 1999 diplomohet me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2013 përfundon studimet Master Niveli II-të në “Të drejtën Kushtetuese dhe Administrative” pranë Fakultetit Juridik, Universiteti Europian i Tiranës.

Ka 17 vite eksperiencë pune në administratën publike, ku ka shërbyer në sektorë të ndryshëm të saj lidhur me draftimin e legjislacionit, prokurimin dhe administrimin publik, si dhe ka mbajtur funksionin e konsulentit lokal për projekte të rëndësishme të infrastrukturës të financuara nga donatorë të huaj si IBD, Opec, Abu Dabi dhe Banka Botërore.

Në vitin 2002 ka marrë titullin “Avokat” të akorduar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Gjatë eksperiencës së saj të punës ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me procedurat e draftimit të legjislacionit, prokurimin publik dhe menaxhimin e kontratave të punimeve civile dhe atyre të konsulencës. Zotëron shume mire gjuhën angleze dhe italiane si dhe në nivel të mirë gjuhën franceze.

Aktualisht, mban pozicionin e Këshilltares Ligjore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.